

Nr.regj. 30766/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehures Afërdita Veliu nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.3 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73,74,195,199 dhe nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **28.12.2012** merr këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA: Afërdita Shaqir Veliu, e lindur më 14.04.1967 në Prishtinë, jeton në Prishtinë, me vendbanim në lagjen Kodra e Trimave, rruga "Rexhep Gjeli" nr.18/1, e punësuar në ngrohtoren e qytetit "Termokos", e pamartuar, me shkollim të mesëm, e gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s e

Sepse, si Zyrtare e Lartë Publike, në pozitë të Këshilltares në Kuvendin Komunal Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.3 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, andaj për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro), të cilën shumë e pandehura është e obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Paga bëhet në ndonjë agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **13 ditësh**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor e pandehura është e obliguar të paguaj shumën prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehures.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate Kërkesën 01-2500/2012 me datë 30.07.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehures së lartshënuar për kundërvajtjen nga neni 9 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.3, e ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.3 të Ligjit 04/L-050.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurën e cila në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë duke shtuar se nga data 17.03.2012 deri më 14.04.2012 ka qenë në Gjermani për shkak të problemeve shëndetsore personale, për çka ofroi si dëshmi kopjen pasaportën e saj, ndërsa deklarin e pasurisë e kishte bërë pas njoftimit se, për mos deklarim të pasurisë është inicuar procedurë gjyqësore kundër saj, saktësisht me datë 17.08.2012 siç shihet edhe nga vërtetimi i AKK. Në vazhdim e pandehura deklaroi se ka qenë në dijeni për obligimin ligjor që ka pasur si deputete-këshilltare në Kuvendin e Prishtinës për deklarin e rregullt të pasurisë deri më 31.03.2012, por këtë obligim e njëjta siç pohon e kishte neglizhuar, por jo me qëllim shmangieje por duke menduar se nuk ka aq pasuri sa për t'u deklaruar, për çka shpreh edhe keqardhjen e

JPK/DMP

03-182/2013

02

28.01.2013

saj për lëshimin e bërë të paqëllimshëm. Në fund e pandehura thekson se nuk ka pasur kërkesë të veçantë nga AKK për deklarim të pasurisë .

Për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, gjyqtarja dëgjoi edhe parashtruesin e kërkesës nga AKK, në cilësi të dëshmitarit, në rrethanën pse është ngarkuar me nenin 9 të të njëjtit ligj, i cili qartësoi faktin se kandidatët të cilët kanë qenë të obliguar për herë të parë të deklarojnë pasurinë, i kishin ngarkuar për mosdeklarim të pasurisë sipas kërkesës së AKK, ndërsa zyrtarja në fjalë nuk e kishte bërë deklarimin e rregullt të pasurisë.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, të dëshmitarit, shqyrtimi i provava materiale dhe i shkresave të tjera të lëndës, administrimi i secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, se e pandehura ka kryer kundërvajtje të precizuar si në diapozitiv të këtij aktvendimi, se e njëjta ka neglizhuar çështjen e deklaramit të pasurisë duke mos i kushtuar rëndësinë e duhur edhe pse ligjërisht ka pasur afat prej 30 ditësh për ta përmbushur këtë obligim për të cilin ka qenë në dijeni nga kolegët e saj deputetë në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, ndërsa disa thënie për zbutje të përgjegjësisë gjyqtarja i konsideroi vetëm si shkas për zbutje të dënimit. Andaj, pas konstatimit se është fjala për mosdeklarim të rregullt të pasurisë të paraparë në nenin 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.3 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit 04/L-050. e jo për deklarim sipas kërkesës së AKK. bëri rikualifikim të kundërvajtjes dhe të pandehurën e shpalli përgjegjëse për këtë kundërvajtje dhe në aplikim të nenit 9 të LK i shqiptoi dënimin nën minimumin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe sipas peshës së kundërvajtjes e shkallës së përgjegjësisë së të pandehures, e duke pasur parasysh paraqitjen e sinqertë të të pandehures në gjykatë dhe shprehjen e keqardhjes, të cilat i konsideroi si rrethana lehtësuese, njëjtën e dënoi me dënim me gjobë të zbutur. të precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se e pandehura në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.30766/2012, datë 28.12.2012

Gjyqtarja
Suzana Çerkini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.